

ASPEKTE PSIKO-SOCIALE TË PROFILEVE TË BASHKËPUNËTOREVE TË ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT NË SHQIPËRI

Msc. Miranda Imami & Msc. Elona Baçi

Msc. Miranda Imami : Specialiste në Sektorin e Kërkesave të Palëve të Treta, Bashkëpunëtorëve dhe të Favorizuarve, në Drejtorinë e Informacionit

Msc. Elona Baçi: Specialiste në Sektorin e Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese, në Drejtorinë e Informacioni

ABSTRAKT

Ky studim ka si objekt analizimin e disa aspekteve psiko-sociale të bashkëpunimit.

Rekrutimi i bashkëpunëtorëve nga ana e Sigurimit të Shtetit ishte e bazuar shkencërisht dhe rezultoi në përgjithësi efikase. Ai vepronte mbi një metodologji të gatshme dhe të provuar në vende të tjera dhe e të huazuar edhe në Shqipëri.

Fenomeni i bashkëpunimit me palën represive është një fenomen i njohur në histori, aq më shumë në situata izolimi, shtypjeje, ku instinkti i mbijetesës i ka shtyrë drejt veprimeve që në situata të zakonshme do të quheshin amorale.

Në regjimet totalitare ajo u shndërrua në një mjet që ndihmonte represionin dhe shtypjen dhe rrjedhimisht forconte sistemin represiv. Ai u ngrit në një metodologji të saktë dhe shkonte sipas një skeme të njohur për rekrutuesin dhe shpesh fatale për bashkëpunëtorin.

Studimi do të përpiket të ngrejë disa pyetje dhe ndoshta edhe të japë përgjigje se përse njerëzit kanë bashkëpunuar, cilat janë ato rrethana dhe faktorë që i kanë shtyrë njerëzit? A duhet t'i gjykojmë bashkëpunëtorët? A e shpëton shpirtin e tyre rrëfimi dhe sa na vlen e vërteta e tyre? A duhet treguar e vërteta dhe a duhet falur bashkëpunëtori?

Për të gjitha këto do të mundohemi të bëjmë një analizë bazuar në mendimin teorik dhe kontekstin shqiptar të bashkëpunimit përmes dokumenteve të Ish Sigurimit të Shtetit dhe rasteve konkrete të bashkëpunimit në periudhën komuniste në Shqipëri.

Studimi i përgatitur do të prezantohet në simpoziumin e organizuar nga AIDSSH me temë: “Aspekte të përndjekjes politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar”.

Fjalë kyce: bashkëpunim, Sigurimi, denoncim, përndjekje, etj.